



VENDIMI MBI IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 11 nëntor 2015

Nr. i lëndës 2013-03

Goran Becic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, mbledhur me 11 nëntor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël Mettraux, Anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. Ryan, Zyrtar i Lartë Ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, Zyrtar Ligjor
Z. Paul Landers, Zyrtar Ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. VENDIMI I PANELIT I DATËS 12 NËNTOR 2014

1. Me 12 nëntor 2014, Paneli miratoj vendimin e mëposhtëm dhe bëri një numër rekomandimesh në lidhje me ankesën e z Becic:

“Paneli me shumicë votash,
Vendos se nuk ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës;

Vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 14 të Konventës;

Vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 1 të protokollit 1 të Konventës;

Kështu që Paneli e gjen të përshtatshme, në dritën e gjetjeve të tij të mësipërme të fakteve dhe ligjit, të bëjë rekomandimet e mëposhtme për Shefin e Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së punës:

Për të siguruar që procedurat ekzistuese të regjistrimit dhe të vlerësimit fillestar për ankesat e paraqitura në EULEX, përderisa ato ndoshta mund të shkelin ushtrimin e mandatit ekzekutiv të misionit, të vlerësohen nga stafi me ekspertizën ligjore si dhe të të drejtave të njeriut si dhe të komunikohet në njësitë përkatëse.

ShM-ja ftohet që të njoftoj Panelin rreth masave që i ka ndërmarrë në lidhje me këtë vendim deri më 31 dhjetor 2014.

2. Vendimi i tanishëm përbën vendimin pasues të Panelit të datës 12 nëntor 2014 dhe rekomandimeve të bëra aty. Kompetenca dhe autoriteti i Panelit për të lëshuar vendime pasuese në vendimet dhe rekomandimet e tij është dhënë në rregullën 45 e tutje të Rregullores së Punës së Panelit (shih p.sh. vendimet mbi zbatimin e rekomandimeve [W kundër EULEX-it](#), 2011-07, 26 gusht 2014; [H&G kundër EULEX-it](#), 2012-19 & 20, 27 maj 2014).

II. INFORMACIONI I PRANUAR NGA SHEFI I MISIONIT TË EULEX-IT

3. Më 6 janar 2015, Shefi i Misionit (ShM) ka njoftuar Panelin se i kishte dhënë konsideratë të duhur rekomandimeve të tij dhe se ai do t'i zbatonte ato. Në veçanti, ai tregoj se procedurat e brendshme për regjistrimin dhe vlerësimin e ankesave dhe letrave që vijnë do të shqyrtohen she kur të jetë e nevojshme ndryshimet do të zbatohen në përputhje me rrethanat.
4. Më 20 maj 2015, ShM-ja ka njoftuar Panelin rreth veprimeve të tij të ndërmarra në zbatimin e vendimit dhe rekomandimeve të Panelit.
5. Ai parashtroj se në fazën e hershme të ekzistencës së misionit ishte krijuar një regjistër qendror për ankesat që vijnë. EULEX-i gjithashtu ka miratuar një procedurë standarde operative (PSO) për komunikimin, korrespondencën e EULEX-it, memorandumet e brendshme dhe përdorimin e postës elektronike. PSO-ja për herë të fundit është ndryshuar më 29 korrik 2014.
6. Sipas PSO-së së ndryshuar, Zyra e Shefit të Stafit (ShS) si rregull është pika hyrëse për korrespondencën e EULEX-it, e po ashtu Zyra e ShS-së është përgjegjëse për procedimin dhe bashkërendimin e saj me njësitë e tjera organizative sipas nevojës. Të gjitha korrespondencat e EULEX-it që duhet të procedohen, regjistrohen nga Zyra e ShS-së. Kur nevojitet ekspertiza e njësive të tjera organizative në mënyrë që korrespondentit t'i kthehet një përgjigje,

Zyra e ShS-së është përgjegjëse për përpunimin e asaj korrespondence dhe do të ngarkoj njësinë përgjegjëse. Kur është e nevojshme, njësi të tjera organizative përkatëse do të ngarkohen me detyra. Njësisë së ngarkuar me detyrë do t'i jepet një afat kohor për përfundimin e të dhënave të kërkuara.

7. Ekspertiza e Zyrës Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut është gjithmonë në dispozicion për Zyrën e ShS-së gjatë vlerësimit të ankesave hyrëse.

III. VLERËSIMI NGA PANELI

8. Paneli tregon kënaqësinë e tij se procedurat për trajtimin e ankesave dhe korrespondencave të tjera nga EULEX-i janë të vendosura dhe në përputhje me rekomandimet e Panelit.
9. Në veçanti, Paneli thekson se Zyra e ShS-së është e detyruar të kërkoj të dhëna nga njësitë e tjera të misionit, kur ekspertiza e tyre është e nevojshme për vlerësimin e ankesave që vijnë, duke përfshirë Zyrën Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut.
10. Megjithatë, Paneli përsërit se procedurat kanë dështuar në këtë rast dhe lënda e ankuesit nuk ishte regjistruar dhe trajtuar siç kërkohet me procedura.
11. Paneli thekson më tej se Zyra e ShS-së duhet të siguroj që kur ankesat dhe korrespondencat të tjera të dorëzuara ka mundësi që mund të lidhen me ushtrimin e mandatit ekzekutiv të misionit, ato duhet në parim të vlerësohen nga stafi me ekspertizë të nevojshme ligjore dhe të drejtave të njeriut, sipas rekomandimit të Panelit.
12. Duke pasur parasysh se çfarë u tha më sipër, Paneli konsideron se këta hapa përbëjnë një zbatim të duhur dhe të mjaftueshëm të rekomandimeve të tij.
13. Pas shqyrtimit të informacionit të dhënë nga ShM-ja në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit,

PANELI NJËZËRI

Deklaron se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet e Panelit.

Vendos të mbyll shqyrtimin e lëndës.

Për Panelin,

John J Ryan
Zyrtar i lartë ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese